



Vrapimi me stafetëve për të sjellë në fokus ndryshimet klimatike do të kalojë përmes Shqipërisë në një udhëtim prej 7767 km 'Running Out of Time' drejt konferencës së COP27

Më 22 Tetor, stafeta e [Running Out of Time](#) do të hyjë në Shqipëri, pasi ajo ka kaluar 7,767 km në 18 vende që përmban një mesazh klimatik nga të rinjtë për liderët botërorë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, COP27.

Vrapimi me pjesëmarrje masive u nis më 30 shtator 2022, nga Glasgow, Skoci (qyteti ku u mbajt Konferenca COP26), për në Sharm el-Sheikh, Egjipt (qyteti ku do të mbahet Konferenca e COP27), në një udhëtim prej 38 ditë dhe netë. Ky është vrapimi me stafetë më i gjatë, pa ndalesa i mbajtur ndonjëherë.



Vrapues, çiklistë dhe marinarë, do të mbajnë stafetën në një itinerary që përfshin Skocinë, Uellsin, Anglinë, Francën, Belgjikën, Hollandën, Gjermaninë, Austrinë, Italinë, Slloveninë, Kroacinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Shqipërinë, Greqinë, Qipron, Izraelin dhe Egjiptin – për të mbërritur në Sharm el-Sheikh më 5 Nëntor 2022, në kohë për COP27 që do të zhvillohet nga 6 deri në 18 Nëntor 2022.

Shikoni [këtu](#) të gjithë rrugën që do të përshkruhet.

Vrapuesit, çiklistët dhe marinarët do të mbajnë stafetën në pista prej 5-10 km të rrugës që përshkon dete, vargmale, akullnaja, shkretëtira, fshatra, qytete dhe kryeqytete. Ajo do të vizitojë qindra shkolla, vende në rreziara dhe projekte të ndryshmeve klimatike për të frymëzuar dhe përkrahur veprimet lokale mbi klimën. Në të njëjtën kohë, vrapuesit do të mbledhin fonde për [Fondacionin për Edukim Mjedisor](#) dhe [Gjurmën e Karbonit](#).

22 Tetor-24 Tetor

SHQIPËRI

22 Tetor / Hani i Hotit / [Linku i transektit](#)

24 Tetor / Gollomboç, Prespë/ [Linku i transektit](#)

E gjithë përpjekja e pjesëmarrësve të vetëdijësuar për të tejçuar një mesazh mbi rëndësinë e natyrës, duhet të përkthehet nga vendimmarrësit si në veprime konkrete, duke i mbajtur zonat e rëndësishme natyrore të paprekura dhe duke tërhequr vendime shkatërrimtare si ndërtimi në Peizazhin e Mbrojtur Vjosë-Nartë.

Edhe njerëzit në mbarë botën që nuk do të mund vrapojnë në pista, janë gjithashtu të ftuar të kalojnë stafetën gjatë [Stafeta Virtuale Botërore](#) më 5 Nëntor 2022, i cili pritet të mbledhë dhjetëra mijëra vrapues, në emër të veprimit për klimën.

Running Out of Time organizohet nga The World Relay Ltd dhe është bërë i mundur falë përpjekjeve bashkëpunuese të një numri të madh [partnerësh dhe mbështetësish](#).

Regjistrohuni për të marrë pjesë: www.running-out-of-time.com